

## Kriteret që duhet të plotësohen

Pasuritë publike që ka në pronësi Bashkia Vau Dejës, mund të jepen në përdorim të tretëve, duke ndjekur procedurat e konkurimit publik për sipërfaqet mbi 200 m<sup>2</sup>, dhe duke përjashtuar nga konkurimi dhënien me qira për sipërfaqet nën 200 m<sup>2</sup>, sipas VKM-ve përkatëse.

Për pasuritë e paluajtshme të llojit; “Truall”, “Ndërtesë”,(bashkë me sipërfaqe funksionale), “Tokë pa fryt”, “Terren Sportiv” etj, të cilat rregullohen me VKM-në nr 54, datë 05.02.2014,”*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, kriteret që duhet të plotësohen për dhënien me konkurim janë:

- Niveli i investimit
- Niveli i punësimit
- Oferta e detyrimit mujor/vjetor të qirasë

Institucioni (në këtë rast Bashkia), mund të vendosë edhe kriteret e tjera shtesë, sipas qëllimit të përdorimit dhe natyrës së pasurisë objekt dhënie me qira.

Për pasuritë e llojit “Arë” dhe “Kullotë”, jepen në përdorim me VKM të tjera, por kriteret e dhënies me qira të tyre janë pothuajse të njëjta me këto të renditura më lart.